



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2019:160585

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06491464

Rev.nr.355/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Milena Gjeriq dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: E. M. dhe F. M., të dy nga fshati B. i M., të cilët i përfaqëson Ekrem Agushi avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurit: H. M. nga fshati B. i M., të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “V. & L.”, me seli në P., sipas autorizimit, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1990/20, të datës 08.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.11.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Pranohet revizioni i të paditurit: H. M. nga fshati B. i M., Prishen aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1990/20, të datës 08.04.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, është vendosur: I. Aprovohet kërkesëpadia e paditëseve E. M. dhe F. M., që të dy nga fshati B. i M. si e bazuar dhe vërtetohet se paditësit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në ... pjesë të paluajtshmërisë në përbërje si vijon: a) njësinë kadastrale nr. ..., me kulturë livadh i kl. ..., në vendin e quajtur “...”, në sipërfaqe prej ...m<sup>2</sup>, ZK B. i M., me këtë matje dhe

përkufizime gjeodezike në veri me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ...deri në pikën..., në gjatësi prej ... m, në vazhdim me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ...deri në pikën..., në gjatësi prej ... m, në lindje me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ...deri në pikën ...në gjatësi prej ... m, në jug me njësinë kadastrale ..., nga pika ...deri në pikën ...në gjatësi prej ...m, dhe në perëndim me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ...deri në pikën ...në gjatësi prej ...m, b) njësinë kadastrale nr. ... me kulturë livadh i kl. III, në vendin e quajtur “...” në sipërfaqe prej ...m<sup>2</sup>, ZK B. i M., me këto matje dhe përkufizime gjeodezike në veri me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ... deri në pikën ... në gjatësi prej ...m, me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ... deri në pikën ..., me gjatësi prej ...m, në lindje me njësinë kadastrale ..., nga pika ... deri në pikën ... në gjatësi prej ...m, në jug me njësinë kadastrale ..., nga pika ...deri në pikën ... në gjatësi prej ...m, dhe në perëndim me njësinë kadastrale nr. ..., nga pika ... deri në pikën ... në gjatësi prej ...m, dhe obligohet i padituri H. M. nga fshati B. i M. që të duroj dhe lejoj paditësit që paluajtshmerinë e përshkruar nën a) dhe b) ta regjistrojnë në regjistrat të paluajtshmerive në bashkëpronësi të tyre, në të kundërtën ky aktgjykim do të shërbej si dokument juridik për bartjen dhe regjistrimin e kësaj paluajtshmerie në bashkëpronësi të paditësve dhe atë secilit nga 1/2 pjesë të paluajtshmerisë. II. Obligohet i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësve tua kompensoj shumën prej 1.967.60 €, mbrenda afatit prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1990/20, të datës 08.04.2024, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit H. M. nga fshati B. i M., ndërsa aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizionin e paditurit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, revizionin e të paditurit ta aprovojë, ndërsa aktgjykimin C.nr.200/2016, të datës 01.11.2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan dhe aktvendimin Ac.nr. 1990/20, të datës 08.04.2024, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, t'i ndryshojë, dhe të refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësve, ose ta aprovojë revizionin dhe çështjen ta kthejë në rivendosje të gjykata e shkallës së parë.

Përgjigje në revizionin e të paditurit kanë paraqitur paditësit, me propozim që të hedhet si i pas afatshëm revizioni i paditësve ose i njëjti të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Përgjigje ndaj përgjigjes në revizion ka paraqitur i padituri, me propozim që revizioni të trajtohet si i afatshëm dhe gjykata të vendos sipas propozimit në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, në gjykatën e shkallës së parë më datë 12.05.2016, kanë paraqitur padi, kundër të paditurit, me të cilën kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke kërkuar më saktësisht si në parashtrësën e datës 10.05.2019.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve, kundër të paditurit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.200/16 të datës 01.11.2019, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: certifikatën për njësit kadastrale ... dhe ..., që të dyja në ZK B. i M., aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan T.nr.49/83 të datës 06.05.1983, aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan T.nr.193/2011, të datës 22.11.2012, procesverbalin e datës 05.04.2019, ekspertizën gjeodezike të hartuar nga ekspertja gjyqësore D. T. – G., të datës 18.04.2019, kopjen e fletës poseduese nr...., procesverbalin e datës 14.05.2019, 13.09.2019 dhe 29.07.2019, kallëzimin penal të datës 09.09.2019, i paraqitur kundër dëshmitarit J. P., aktvendim e lëshuar nga Enti Komunal për Siguri Sociale Nr. ..., aktvendimin C.nr.199/2016 të datës 25.01.2019, aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3145/19 të datës 16.07.2019, procesverbalin C.nr.316/2016 të datës 17.04.2018.

Ka shtuar se në mes palëve ndergjyqëse nuk është kontestues fakti se i ndjeri R. M. ishte gjyshi i tyre, ndërsa i ndjeri R. M. i ati i H. M., të paditurit, i ndjeri Q. M. i ati i E. M. dhe i ndjeri I. M. i ati i F. M..

Nga certifikata për njësinë kadastrale P-... ZK B. i M. e lëshuar nga ZKK në L. më datë ..., rezulton se ngastrat kadastrale kontestuese numër - ZK B. i M., në zyrën komunale kadastrale, në regjistrat ku mbahet evidenca e palujtshmerive në pronësi në sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup>, udhëhiqet në emër të palëve ndergjyqëse pjesa e pronës prej ... .

Nga certifikata për njësinë kadastrale P-... ZK B. i M. e lëshuar nga ZKK në L., më datë ..., rezulton se ngastrat kadastrale kontestuese numër ... - ZK B. i M., në zyrën komunale kadastrale, në regjistrat ku mbahet evidenca e palujtshmerive në pronësi në sipërfaqe prej ... m<sup>2</sup> udhëhiqet në emër të palëve ndergjyqëse pjesa e pronës prej ... .

Nga aktvendimi i Gjykatës Komunale në Lipjan T.nr.49/83 të datë 06.05.1983, rezulton se trashëgimtar për pasurin trashëgimore të të ndjerit R. M., ish nga fshati B. i M., për ..., e pjesës ideale janë shpallur Q. M., R. M. dhe I. M., që të tre të bijtë e të ndjerit, që të tre ish nga fshati B. i M. , ku janë përfshirë edhe ngastrat kadastrale kontestuese.

Nga aktvendimi i Gjykatës Komunale T.nr.193/2011, i datës 22.11.2012, rezulton se trashëgimtar për tërë pasurin trashëgimore të të ndjerit R. M., edhe për ngastrat kadastrale kontestuese është shpallur H. M. e tani i padituri për ... , e pasurisë trashëgimore.

Nga ekspertiza gjeodezike e hartuar nga ekspertja gjyqësore e gjeodezisë D. T. – G. rezulton se parcela nr.... dhe ... në ZK B. i M., në zyrën komunale kadastrale të L., është e regjistruar në emër të F. M. ..., H. M. ... dhe E. M. ..., parcela nr. ... kufizohet në anën veriore me parcelën nr. ... nga pika ...deri në pikën nr.... me gjatësi prej ...m, me parcelën ... nga pika ... deri në pikën

...në gjatësi prej ...m, në pjesën lindore kufizohet me parcelën nr. ... nga pika ...deri në pikën ...në gjatësi prej ...m, në pjesën jugore me parcelën nr. ..., nga pika ... deri të pika ... në gjatësi prej ...m, dhe në perëndim me parcelën nr...., nga pika ... deri në pikën ... në gjatësi prej ...m, ndërsa parcela nr. ..., përkufizohet në veri me parcelën nr. ... nga pika ... deri te pika nr. ... në gjatësi prej ...m, me parcelën nr. ..., nga pika ...deri në pikën ..., me gjatësi prej ...m, në lindje me parcelën ... nga pika ... deri në pikën ... në gjatësi prej ...m, në jug me parcelën ... nga pika ... deri në pikën ...në gjatësi prej ...m, dhe në perëndim me parcelën nr. ..., nga pika ... deri në pikën ... në gjatësi prej ... m.

Ka theksuar se nga këto prova të administruara, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i ndjeri R. M., ka qenë gjyshi i paditësve, i cili i ka pasur tre djem dhe dy vajza dhe atë R. M., baba i të paditurit H. M., Q. M., baba i paditësit E. M. dhe I. M. baba i F. M., se në vitin 1960 i ndjeri R. M., baba i të paditurit është ndarë nga bashkësia familjare me vëllezër dhe babën e tij dhe me këtë rast ka marr vetëm truallin dhe një shtëpi të cilën bashkërisht e kanë ndërtuar, të ndjeret vëllezërit me babën e tyre, se në vitet 1980-ta, baballarët e paditësve, e kanë ndarë pasurinë e përbashkët të paluajtshme në mes veti, meqë rast prezentë përveç vëllezërve, baballarëve të palëve ndërgjyqësore i ndjeri gjyshi i palëve ndërgjyqësore R. M., kanë qenë edhe nipi i tyre J. P. nga fshati M., si dhe të ndjerët V. R., A. M., Sh. M., se me marrëveshje gojore mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët të paluajtshme paluajtshmëritë kontestuese u kanë takuar në pjesë të barabarta të ndjerit Q. M. baba i paditësit E. M. dhe I. M. baba i paditësit F., se që nga ajo kohë e deri sa kanë qenë në jetë baballarët e paditësve e pas tyre paditësit këto parcela i kanë shfrytëzuar këto parcela pa asnjë shqetësim nga askush përderisa të njëjtat janë shpronësuar dhe ka filluar ndërtimi i autostradës P. – H. E. .

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga dëgjimi i dëshmitarëve J. P. nga fshati M., I. M., S. M. që të dy nga fshati B. i M., pjesërisht nga dëshmia e dëshmitarit M. Z. i cili deklaroj se këtë livadh e ka punuar Q. baba i E. dhe I. baba i F., për tërë kohën ndërsa asnjëherë nuk e kam parë duke punuar këtë tokë R. - babën e të paditurit, nga deklarata e paditësve E. dhe F. M. të dhënë në cilësi të palëve, prova këto të cilave gjykata ua fali në tërësi besimin nga se ishin bindëse dhe e plotësonin njëra tjetrën.

Ka shtuar se me nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr 6), parashihet se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi. Me nenin 28 paragrafi 4 i po të njëjtit ligj, parashihet se mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send në parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar gjykata e shkallës së parë zbatoi dispozitat e LMTHJP-së, dhe gjeti se paditësit kanë fituar të drejtën e pronësisë në 1/2 e paluajshmërive, me përafërsisht të përshkruara në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, mbi bazën e parashkrimit fituese, nga se paraardhësit e paditësve me ndarjen e pasurisë së paluajtshme të përbashkët në vitet 80-ta, ua ka takuar nga 1/2 e këtyre paluajshmërive, që nga vitet 1980-ta kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paluajshmërive kontestuese përderisa kanë qenë gjallë e pas tyre paditësit i posedojnë dhe shfrytëzojnë në mënyrë të ligjshme dhe me mirëbesim, me tepër se 20 viteve dhe këtë paluajshmëri e ka shfrytëzuar pandërprerë dhe në mënyrë të qetë dhe të pa penguar

nga askush, deri më sot e kësaj dite, për çka edhe gjykata aprovojë kërkesëpadinë e paditësve si nën al. I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi si të bazuar.

Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe deklaratimet e palës se paditur se palujtshmëria kontestuese është blerë nga babi i tij, i ndjeri R. në vitet 1963-1964, me të hollat që i ka marr në emër të dëmshtëpërblimit për lëndimin e këmbës në vendin e punës në firmën “...” në M., por kjo palujtshmëri është regjistruar në emër të gjyshit të tij të ndjerit R. M., për mos me pengu me i shfrytëzuar shtesat e fëmijëve, dhe se për 1/3 e paluajtshmërive kontestuese me rastin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore të gjyshit i ka takuar babait të tij, të ndjerit R. M. dhe pas vdekjes së tij për këtë pjesë të paluajtshmërisë është shpallur trashëgimtar dhe kjo pjesë të paluajtshmërisë në regjistrin ku mbahet evidenca e paluajtshmërive në pronësi udhëhiqet në emër të tij dhe është pasuri e tij por të njëjtave deklaratime në mungesë të provave materiale, gjykata nuk mundi tua falë besimin, këtë për faktin se aktvendimet e trashëgimisë, sipas gjykatës kanë vetëm karakter deklarativ, ndërsa nga dëshmitë e dëshmitarëve të cilave gjykata ua fali besimin, u vërtetu në mënyrë të plotë dhe bindës se paluajtshmëria kontestuese u ka takuar baballarëve të paditësve me ndarjen e pronës së përbashkët familjare, e të cilët të njëjtit sa kanë qenë në jetë e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzuar pandërprerë, e pas tyre paditësit e kanë shfrytëzuar dhe poseduar pa ndërprerë dhe pa u shqetësuar nga askush me mbi 20 vite.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 20 paragrafi 1 dhe 28 paragrafi 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr 6) dhe nenit 143 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Ac.nr.1990/20, të datës 08.04.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetua, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës , aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës.

Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike, jep përfundimin mbi aprovimin e kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet e palëve duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë..

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe as të dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj faktet me rëndësi për të vendosur sipas padisë së paditësve, për arsye se: nëse i referohemi pretendimeve të palëve kemi të bëjmë me pretendimin se paditësve se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në 1/2 pjesë të paluajtshmërisë në përbërje në ngastrat kadastrale të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, ndërsa i padituri e ka kundërshtuar në tërësi një pretendim të tillë.

Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale - kontestuese, në të cilën paditësit kanë pretenduar se kanë të drejtën e bashkëpronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësit, të identifikojë saktësisht se cila është parcela/t kadastrale apo pjesa e saj/tyre, në të cilën paditësit kanë pretenduar se kanë të drejtën e pronësisë, më saktësisht si në kërkesëpadi dhe lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë kadastrale, a e kanë në posedim paditësit një pjesë apo në tërësi parcelën/at, në momentin e shikimit në vend, apo ndonjë

palë e tretë, gjithashtu nuk e ka udhëzuar ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë/ve kontestuese sipas gjendjes faktike në vend, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar historiatiin e pronës, nuk ka e ka bërë ballafaqimin e dëshmitarëve edhe pse në deklaratat e tyre ka pasur kundërthënie, nuk ka marr në shikim shkresat e lëndës T.nr.49/83, T.nr.193/2011, C.nr.199/2016, C.nr.316/2016, e provat e administruara si provë nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë në kopje, nuk është sqaruar fakti se kurë realisht është shkëputur bashkësia familjare në mes të paraardhësve juridik të palëve ndërgjyqësve (pretendohet se ka ndodhur në vitin 1960, por nuk është vërtetuar saktësisht, nuk është sqaruar fakti se kur është bërë ndarja e pasurisë në mes të paraardhësve juridik të palëve ndërgjyqësve, çka realisht ka qenë objekt i ndarjes në vitet e 80-ta - cila pasuri, nuk është vlerësuar mirëbesimi si kusht për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në raport me provat e administruar, dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët, të udhëzojë ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit - raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në L., të kërkohe historiati i pronës për paluajtshmërinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, të marrë në shikim shkresat e lëndës: T.nr.49/83, T.nr.193/2011, C.nr.199/2016, C.nr.316/2016, të bëjë ballafaqimin e dëshmitarëve për ti eliminuar kundërthëniet në mes tyre, te vlerësohet mirëbesimi si kusht për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në raport me provat e administruara, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin

Numri i lëndës: 2019:160585

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06491464

do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.355/24, datë 18.11.2024.

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi